



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 226, datë 08.05.2023

PËR

**PËRJASHTIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}, NGA PROCEDURAT E KOMANDIMIT
SI PEDAGOGE E BRENDSHME PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 08.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe projekt opinionin “Mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin përkatës,

VËREN

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja “d” dhe nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 ka vendosur: “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”.
2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar data 13 shkurt.
3. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur kërkesë vetëm një kërkesë.
4. Me aktin nr. 1190, datë 10.02.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Znj.{...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës për pozicionin “Pedagog i brendshëm, me drejtim formimin vazhdues”.
5. Në vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit, konkretisht **në Kreun II** të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli. “Për vlerësimin e kushteve të

kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

6. Vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies dhe i kriterëve shtesë për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatin për depozitimin pranë saj të çdo dokumentacioni tjetër shtesë, me qëllim vlerësimin e plotësimin të kriterëve të tjera të parashikuara në Aneksin 11 të Rregullores së Shkollës.”
7. Sipas parashikimit të bërë në pikën 8 të Kreut II, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës”.
8. Në pikën 10 dhe 11 të këtij Kreu, parashikohet se: “Përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të kërkesës për komandim nga Shkolla, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarit të përzgjedhur, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Shkollën e Magjistraturës.”
9. Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit **në fazën e parë**, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.
10. Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës hartoi Projekt-opinionin për kandidaten {...}. Sa më sipër, në përgatitjen e këtij opinionin për këtë candidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon për këtë candidate, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushteve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim, si edhe vlerëson kriteret e tjera të komandimit përveç mësimdhënies, dhe i paraqitur Këshillit propozimet përkatëse.

II. Vlerësimi i Këshillit

i. Në lidhje me kushtet ndaluese të komandimit

11. Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 3, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 40, datë 27.01.2023. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kushtet e komandimit janë:

a) *Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;*

b) *Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;*

c) *Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;*

ç) *Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;*

d) *Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.*

12. Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 3, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, më datë 17.02.2023, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

Znj. Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekret nr. 8353, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. 9235, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrorë detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi

13. Në këto rrethana, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kusht ndalues komandimi.

ii. Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës

14. Sa i përket cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga zëvendëskryetari i gjykatës respektive, rezulton se: “...Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, aktualisht gjykojnë 8 (tetë) gjyqtar, të cilët sipas Urdhrit Nr. 111 Prot., datë 24.05.2021 vijoje duke gjykuar në një seksion të vetëm. Nga statistikat e vitit 2022 rezultojnë

se janë gjykuar 7166 çështje në total, duke u përballuar kjo ngarkesë nga vetëm 6-7 gjyqtar efektiv. Gjyqtarja Znj. {...} (Pogaçe){...}, nga muaji Korrik 2021-Shtator 2022 ka qenë me leje lindjeje. Aktualisht gjyqtarja ka në shqyrtim 390 çështje në shqyrtim.

Është fakt i ditur tashmë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është konsideruar si një nga gjykatat në krizë, sa i përket numrit të çështjeve që paraqiten në raport me numrin e gjyqtarëve efektiv. Nga ana e Zv/Kryetarit të Gjykatës gjate vitit 2022 është mbajtur korrespondencë me KLGJ, me qëllim gjetjen e mekanizmit të duhur për shtimin e gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Me vendimin Nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor vendosi që për Gjykatën e Durrësit të hapen dy transferime të përkohshme dhe katër me lëvizje paralele. Po ashtu, se shpejti edhe Gjykata e Kavajës pritet të bashkohet me Gjykatën e Durrësit.

Në cilësinë e Zv/Kryetarit të Gjykatës, vlerësoj se gjyqtarja Znj. Pogaçe (Tafa) i ka aftësitë e duhura për të qenë pjesë e stafit të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, si pedagoge e brendshme. Por, vlerësoj se momentalisht largimi i gjyqtarës do të sillte efekte negative për gjykatën, nisur nga ngarkesa e madhe që po përballohet dhe mungesa e gjyqtarëve.

15. Së fundmi, sjell në vëmendje se Zv/Kryetari i Gjykatës disa ditë më parë ka dhënë opinionin e tij në lidhje me një gjyqtare tjetër të kësaj gjykatë për transferim, por që dallimi në këtë rast duhet bërë tek qëllimi, i cili në fund të ditës mbetet evadimi i çështjeve dhe kthimin e situatës në normalitet në gjykata.”
16. Këshilli, sa i përket situatës në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës ka ndërmarrë disa hapa për ta përmirësuar atë, si: hapja e procedurës së lëvizjes paralele, transferimi i përkohshëm i dy gjyqtarëve në këtë gjykatë, (përkatësisht vendimet nr.21-24 dhe 31-32 datë 18.01.2023) dhe vendimi nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”. Sipas parashikimeve të këtij vendimi, gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Si rezultat, në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka rritje numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë edhe me 3(tre) gjyqtarë të transferuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
17. Kjo situatë e parashtruar në paragrafin e mësipërm vlerësohet përballë opinionit të përcjellë nga zëvendëskryetari i gjykatës respektive. Rrethanat e reja të krijuara nëpërmjet: i)hapjes së procedurës së lëvizjes paralele; ii) transferimeve të përkohshme; dhe iii) transferimeve të gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Kavajë për shkak të hartës gjyqësore ndikojnë drejtpërsëdrejti dhe pozitivisht në funksionalitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

iii. Kriteret e komandimit përveç atij specifik të mësimdhënies

18. Në pikën Kreun II, pika 8 të vendimit 40/2023, është parashikuar se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollën së Magjistraturës emrat e kandidatëve **që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies.**

18.1 Kriteret e komandimit për pozicionin “Pedagog i brendshëm” janë:

- a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose
- b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

18.2 Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, **ku parashikohet eksperiencia mbi 10 vjet si gjyqtar.**

19. Këshilli, për të analizuar këtë kriter mbështetet në parashikimin e pikës 6 të vendimit nr. 40/2023. Në këtë vendimin është përcaktuar se: *“Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.”.*

20. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbi kërkesën e Shkollës së Magjistraturës bazuar në nenin 265 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” inicioi procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm. Në këtë nen parashikohet se: *“ 1. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës mund t’i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë që gjyqtarë ose prokurorë në detyrë të komandohen si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në procedurën e përcaktuar në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Verifikimi i kriterit ligjor të eksperiencës si gjyqtar, është një kriter që verifikohet nga Këshilli si organi, i cili administron dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit.

21. Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, rezulton se znj. {...} është caktuar përkohësisht në detyrë në 21 tetor 2013. Gjyqtarja {...}, në momentin e aplikimit për pozicionin e pedagogut të brendshëm, ka vjetërsi në detyrë 9 vjet e 3 muaj.

22. Në këto rrethana, për kandidaten {...} vlerësohet se nuk plotësohet kriteri ligjor i vjetërsisë në detyrë mbi vjet.

III. KONKLUZIONE

23. Referuar përcaktimeve të Vendimit 40/2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për pozicionin si pedagoge e brendshme për kandidaten znj. {...}, bazuar në rezultatet e verifikimit, Këshilli çmon se është vendi për përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjë “b”, pika 1, të nenit 97, nenin 264 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për komandimin në pozicionin e pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës bazuar në Vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet.
2. Publikimin e këtij opinionioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR